# A K T - T H E M E L I M I

Une Shkelqim Faslli Kapllanaj i dtl.1966 lindur ne Ngracie Mallakaster dhe banues ne qytetin e Ballshit,shtetas shqiptar,ne mbeshtetje te ligjeve 7632 date 4.11.1992,Nr.7638 date 19.11.1992 dhe 7667 date 28.1.1993 vendosa te themeloj shoqerin me pergjegjesi te kufizuar me kushtet e me poshteme:

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " SHKELQIMI " krijohet me mjetet vetjake te ortakut te vetem themelues i saj.

Neni 2

Selia e qendra e kesaj shoqerie do te ndodhen ne lagjen " 5 Shkurti" te qytetit te Ballshit.

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet:"S H K E L Q I M I " Ballsh.

Ajo do te kete edhe emertimin e shkurtuar:SH.P.K." S H K E L Q I M I ".

Neni 4

Shoqeria do te krijohet mbi bazen e nje kapitali themeltar prej 100 000 lekesh qe jane ne pronesi te ortakut te vetem.

Neni 5

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

Neni 6

Sh.P.K. do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

1.Ndertime te ndryshme objektesh e lokalesh,ujesjellsash,rrugesh,ndertesash, kanalizimesh si dhe riparime te pjeseshme dhe te plota te ketij lloji.

2.Tregetim me shumice e pakice i materialeve te ndertimit,mallrave industriale dhe ushqimore,[illegible],makinash e makinerish si brenda ashtu edhe jashte shtetit.

Neni 7

Organi i vetem drejtues dhe administrues i SH.P.K. eshte administratori i SH.P.K. Administrator do te jete Z.Shkelqim Kapllanaj qe eshte themelues dhe ortak i vetem i kesaj SH.P.K.-je.

Neni 8

SH.P.K.do te mbyllet vetem ne rastet kur veprimtaria e saj bie ndesh me ligjin shqiptar,ose aktiviteti i saj perfundon me humbje dhe nuk gjendjen rruge te tjera per ta nxjerr nga gjendja e falimentimit.

Neni 9

SH.P.K.-ja e fiton personalitetin e saj,mbasi te rregjistrohet ne gjykaten e Tiranes si persona juriridik,ku do te depozitohet edhe nje kopje e aktit te themelimit si dhe nje kopje e statutit te saj.

Neni 10

Per te percaktuar ecurin e metejshme dhe proceduren e punes ne vazhdim do te hartohet edhe statuti perkates i SH.P.K.-se,qe do ti bashkengjitet aktit te themelimit.

THEMELUESI I SH.P.K."SHKELQIMI "
ORTAKU I VETEM
SHKELQIM KAPLLANAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE MALLAKASTER
Nr. 3781 i rep.

VERTETIM

Sot me daten 16.09.1999 para meje noterit Kadri Bilali u paraqiten personalisht Z.Shkelqim Kapllanaj i biri i Faslliut i dtl.1966,lindur ne ngracie e banues ne Ballsh, me zotsi te plot juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje, i cili nenshkroi ne pranin time kete akt themelimi te sh.P.K."SHKELQIMI" dhe une noteri e vertetoj rregullisht.

N O T E R I
KADRI BILALI

PULLE TAKSE
100 LEKE
SHQIPERISE

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " S H K E L Q I M I "

Ne mbeshtetje te ligjeve Nr.7632 date 4.11.1992,Nr.7638 date 19.11.1992 dhe Nr.7667 date 28.1.1993 "Per shoqerite tregetare dhe ne baze te aktit te themelimit,une Shkelqim Faslli Kapllanaj i dtl.1966,lindur ne Ngracie Mallakaster e banues ne qytetin e Ballshit,shtetas shqiptar,krijova shoqerin me pergjegjesi te kufizuar " S H K E L Q I M I " per aktivitetin ne vazhdim te se ciles nxjer kete statut:

### DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " Š.H K E L Q I M I " krijohet me mjetet vetjake te ortakut te vetem,themelues i saj.

Neni 2

Selia dhe qendra e shoqerise private me pergjegjesi te kufizuar " S H K E L Q I M I " ndodhet ne qytetin e Ballshit ne lagjen " 5 Shkurti".

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet " S H K E L Q I M I " Ballsh.

Ajo do te kete edhe emertimin e shkurtuar "S H K E L Q I M I " SH.P.K. Ballsh.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " S K K E L Q I M I " do te kete vulen e saj.

Vula do te kete forem te rrumbullaket ku do te jene shenuar inicialet SH.P.K."SHKELQIMI" imp.eksp.Ballsh Albania.

Neni 5

Shoqeria do te kete statusin e personit juridik shqiptar.

Gjithe aktiviteti i saj do te zhvillohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne rastet kur kjo shoqeri do te hyje me marrdhenie juridike me persona juridik apo fizik te huaj,veprimtaria e saj do te jete ne perputhje edhe me legjislacionin e shtetit perkates ku do te kryhen veprimet juridike.

Neni 6

Objekti i SH.P.K." SHKELQIMI" do te jete:

1.Ndertime te ndryshme objektesh e lokalesh,ujesjellesash,rrugesh,ndertesash,kanalizimesh si dhe riparime te pjesshme apo te plot te ketij lloji.

2.Tregetimi me shumice e pakice i materialeve te ndertimit,mallrave industriale e ushqimore,[illegible] makinash e makinerish si brenda ashtu dhe jashte shtetit.

Neni 7

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " SHKELQIMI" do te ushtroj aktivitetin e saj ne qytetin e Ballshit si dhe ne rrethe te tjera te vendit, sipas leverdise ekonomike qe do te kete.

Neni 8

Aktiviteti i SH.P.K.(objekti i saj),emertimi e selia mund te ndryshohen gjate vazhdimit te veprimtarise vetem me vendim te administratorit te saj.

MJETET E SHOQERISE

Neni 9

SH.P.K." SHKELQIMI " e fillon aktivitetin e saj mbi bazen e nje kapitali themeltar prej 100 000 lekesh.

Shoqeria ka ne pronesin e saj edhe mjete te tjera te nevojshme per fillimin dhe vazhdimin panderprerje te aktivitetit sipas objektit.

Neni 10

Ne mjetet e shoqerise do te futen ne te ardhmen edhe ato objekte dhe sende si dhe te holla te fituara nga shoqeria gjate aktivitetit te saj te ligjeshem ne perputhje me kete statut dhe aktin e themelimit.

Neni 11

Per detyrimet e veta si ndaj shtetit ,ashtu edhe ndaj personave te trete me te cilet do te hyje ne marrdhenie dhe do te kete detyrime SH.P.K.pergjigjet deri ne nivelin e plot te mjeteve te saj.

Neni 12

Per sigurimin e plotsimit te detyrimeve SH.P.K.do te kete fondin rezerve qe do te krijohet nga fitimet e saj dhe ne baze te ligjit.

Neni 13

Fondi rezerve do te krijohet duke vecuar 1/20 pjese te fitimit te vitit te mepareshem te realizuar dhe kjo do te sherbej si rezerve e domosdoshme.

Neni 14

Me vendim te administratorit ne fondin rezerve mund te perfshihet nje mase me e madhe e fitimit per te perballuar detyrimet qe mund te kete ndaj te treteve dhe shtetit.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 15

Organi i vetem drejtues i shoqerise do te jete administratori i saj.

Administrator i kesaj shoqerie do te jete ortaku themelues i saj Z.Shkelqim Kapllanaj.

Neni 16

Administratori eshte organi me i larte vendimor dhe ekzekutiv i SH.P.K.

Neni 17

Administratori ka keto kopetenca:

1.Organizon dhe drejton gjithe aktivitetin e shoqerise dhe nxjerrjen e saj

me fitime.

2.Perfaqeson SH.P.K.-ne ndaj personave te trete qofshin keta fizik apo juridik dhe ndaj shtetit,apo punonjesve te tjere te punesuar ne kete shoqeri.

3.Vendos per hapjen e sektoreve e njesive te tjera me te vogla organizative.

4.Emeron dhe shkarkon pergjegjesat e ndryshem qe vendosen sipas nevojave dhe menyres se organizimit.

5.Percakton dhe emeron punonjesit e administrates dhe bene ndarjen e punes per ta.

6.Vendos per fondin e pagave,pagat e punes,shperblimet e tjera qe mund te jepen sipas rastit dhe masa konkrete e tyre.

7.Vendos per ndryshimin e formes se organizimit dhe drejtimit,si dhe per pushimin dhe mbylljen e aktivitetit te shoqerise.

8.Percakton aktet dhe dokumentat e ndryshme qe perbejne sekret per kete shoqeri dhe qe nuk duhet te perhapen,si dhe masat konkrete qe mund te aplikohen ne se ky rregull shkelet,duke u mbeshtetur edhe ne legjislacionin e punes.

Neni 18

Vula e shoqerise vendoset vetem per te vertetuar nenshkrimin e administratorit.

Neni 19

Ne rastet e largimit te administratorit te drejten e vertetimit te nenshkrimit me vulle e ka personi i autorizuar me shkrim prej tij.

MENYRAT DHE KUSHTET E NDARJES SE FITIMIT

Neni 20

SH.P.K."SHKELQIMI" perballon me te ardhurat e saj detyrimet qe do te kete shpenzimet e ndryshme etj.

Neni 21

Nga fitimi i realizuar me vendim te administratorit mund te behen investime te tjera per permiresimin e kushteve te punes,investime ne kapitalin themelor e ate variabel.

Neni 22

Nga fitimi i realizuar mund te investohet ne persona te tjere fizik apo juridik vendas apo te huaj,mund te behen sponsolizime,te jepen ndihma etj.

ORGANIZIMI I PERDITSHEM I PUNES NE SH.P.K.

Neni 23

Per te bere me te manovrueshem aktivitetin e saj me vendim te administratorit,mund te vendoset per hapjen e sektoreve te tjere,apo njesive me te vogla organizative.

Neni 24

Njesit apo sektoret e hapur nuk kane status te vecante.Ato veprojne si pjese perberese e kesaj SH.P.K.

SH.P.K. gezon te gjitha te drejtat dhe merr persiper te gjitha detyrimet per keto njesi.

Neni 25

Administratori cakton edhe ekspertim kontabel dhe urdheron kryerjen e analizave te ndryshme te prodhimit,statistikave,bilanceve te punes sipas afateve ligjerisht te percaktuara.

KOHEZGJATJA DHE MBYLLJA E SH.P.K.-se

Neni 26

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " S H K E L Q I M I " krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet panderprerje.

Neni 27

Kohezgjatja e aktivitetit te SH.P.K. do te percaktohet nga aktiviteti i saj dhe nga nevoja qe do te kene te tretet per sherbimet qe ajo do te kryej,nga leverdia ekonomike e qendrueshmeria e kapitalit themeleltar e themelor.

Neni 28

Shoqeria mbyllet ne keto raste:

1.Kur aktiviteti i saj bie ndesh me ligjin.

2.Kur shikohet se po shkon drejt falimentimit dhe nuk mund te gjendjen rruge per ta nxjerr me fitime.

3.Hapet ndaj saj procedura e likujdimit.

Neni 29

Kur hapet ndaj shoqerise procedura e likujdimit dhe perfundon me humbje administratori bene shlyerjen e llogarive sipas detyrimeve me kapitalin rezerve dhe ate themelor.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 30

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " S H K E L Q I M I " e fiton zotsin e saj per te vepruar me rregjistrimin e saj ne gjykaten e rrethit Tirane ne rregjistr tregetar,ku do te depozitohet sebashku me kerkesen edhe nje kopje e ketij statuti d e aktit te themelimit.

THEMELUESI I SH.P.K." S H K E L Q I M I "

ORTAKU I VETEM

SHKELQIM KAPLLANAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE MALLAKASTER

Nr. 3784 i rep.

V E R T E T I M

Sot me daten 16.09.1999 para meje noterit Kadri Bilali u paraqit personalish Z.Shkelqim Faslli Kapllanaj,me zotsi te plot juridike per te vepruar i njohur personalisht i cili nenshkroi kete statut dhe une noteri e vertetoj rregullisht.

N O T E R I

KADRI BILALI